



Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

ELBASAN

Qershor 2020

Në shkurt të vitit 2018 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Elbasan. U caktua pika e kontaktit në bashkinë Elbasan për programin ROMACTED nga Kryetari i Bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të koordinuar procesin e zbatimit në nivel vendor.

Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task Forcës së Bashkisë (TFB) u ngritën zyrtarisht në Elbasan gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2018.

Programi ROMACTED ka kontribuar në përmirësime të konsiderueshme në jetën e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Elbasan duke u fokusuar posaçërisht tek vetëfuqizimi i romëve dhe krijimi i urave të komunikimit mes autoriteteve vendore dhe romëve dhe egjiptianëve.

Arritjet kryesore

DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED

- Sondazhi bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Kryerja e vlerësimit të nevojave në nivel komuniteti – identifikimi dhe kuptimi i karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, burimeve dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i aktorëve të interesuar – identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Lista e prioriteteve të komunitetit – u identifikuan gjithashtu masat, mjetet dhe aktorët, që kontribuojnë në përmbushjen e nevojave prioritare;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit – përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të miratuara mes anëtarëve të Grupit të Task Forcës në nivel bashkie;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit – duke marrë parasysh afatet e parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që i ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit vjetor dhe në buxhetimin afatmesëm;
- **Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022**, miratuar nga këshilli bashkiak i Elbasanit më 30 prill 2020.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE



Pesë anëtarë të Grupit të Task Forcës së Bashkisë (TFB) u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë vitit 2018, për "Hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit për integrimin e romëve në nivel vendor" gjatë vitit 2019, kurse dhjetë anëtarë të TFB u trajnuan për "Buxhetimin me përgjegjshmëri rome në nivel vendor" gjatë vitit 2020.

PUNËSIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL

- 37 të rinj romë u informuan për mundësitë e ndryshme në lidhje me programet e punësimit publik në Zyrën e Punës në Elbasan: kurse profesionale dhe trajnime në punë, kurse praktike dhe mbështetje për punësimin e grave nga përfaqësuesit. Përveç kësaj, të rinjtë u informuan për pozicionet e punës dhe kërkesat e punëdhënësve të sektorit privat. Këto takime çuan në rezultate të konsiderueshme pasi 25 të rinj romë u regjistruan në kurse profesionale (për t'u trajnuar si berberë, hidraulikë, parukierë dhe rrobaqepës) ofruar nga Drejtoria e Formimit Profesional të Elbasanit.
- Në kuadrin e aktiviteteve afatshkurtra në nivel komuniteti, 15 të rinj romë morën pjesë në kurse artizanale.
- Anëtarët e Grupit Komunitar të Veprimit zhvilluan disa takime për promovimin e programeve aktuale të punësimit. U organizua një panair pune me punëdhënës të mundshëm nga sektori privat i Elbasanit në maj të vitit 2019 për të informuar komunitetin për mundësitë e ndryshme të punësimit. Si rrjedhojë, tetë romë dhe egjiptianë u punësuan në dy fabrika, që operojnë në fushën e përpunimit të plastikës dhe kavanozëve prej qelqi me mbështetjen e Zyrës së Punës së Elbasanit.




ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR



- Lehtësuesi ROMACTED, në bashkëpunim me anëtarët e GKV lehtësuan regjistrimin e sa vijon: 25 fëmijë në kopsht dhe në shkollat fillore "Hamit Mullisi" dhe "Qemal Haxhihasani"; 16 nxënës në shkollën e mesme "Ahmet Dakli" dhe "Ali Myfitu"; dhe 5 nxënës nga Rrapishta dhe "Beqir Dardha" u regjistruan në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit.
- Në 7 maj 2018, drama "Ena e Drunjtë" nga Edmund Morris u performua nga nxënësit romë me rastin e aktivitetit vendor të prezantimit, ku morën pjesë 300 pjesëmarrës, konkretisht anëtarë të komunitetit rom, përfaqësues të Bashkisë Elbasan, institucionet vendore, shkollat, zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) si organizatë mbështetëse.
- U organizuan një sërë seancash informimi për kulturën dhe trashëgiminë rome me mbështetjen e anëtarëve të rinj të GVK.

REGJISTRIMI NË GJENDJEN CIVILE

Pesë fëmijë romë u regjistruan në zyrën e regjistrimit të shtetëzimit, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm (çertifikatë lindjeje, dokumentet e prindërve dhe karta e identitetit).




INFRASTRUKTURA



U bë pastrimi i hapësirave publike dhe zëvendësimi i ndriçimit në lagjen Rrapishta "5 Maji" në Elbasan.

MASAT NDAJ COVID-19

- U ofrua informacion për komunitetet rome dhe egjiptiane gjatë shpërthimit të pandemisë së Covid-19 në gjuhën angleze dhe shqipe;
- U hartua lista vendore e familjeve rome dhe egjiptiane dhe të moshuarve në Elbasan, që kishin nevojë për mbështetje emergjente dhe për vlerësim të nevojave urgjente;
- Iu dërgua një kërkesë për nevojat urgjente lidhur me Covid-19 në Elbasan drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe Grupit Insitucional të Punës;
- Masa koordinuese me Bashkinë Elbasan dhe ofrimi i 120 paketave të ndihmës së emergjencës në Bashkinë Elbasan, në lagjet Rrapishtë dhe Dyli Haxhire.



Strukturat e Programit

GRUPIT KOMUNITAR TE VEPRIMIT (GVK)
GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)
GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



GRUPIT KOMUNITAR TË VEPRIMIT (GVK)



Bashkia Elbasan ka një grup komunitar veprimi të përbërë nga 8 deri në 10 romë dhe egjiptianë, nga të cilët 5 janë gra. Ky grup takohet një herë në muaj. Deri në mars të vitit 2020 u organizuan 19 takime të këtij grupi me pjesëmarrjen e 165 romëve dhe egjiptianëve, si dhe me praninë proaktive të 71 grave rome dhe egjiptiane që ngritën zërin për nevojat e tyre, duke bërë kërkesa për nevojat e tyre specifike dhe duke u takuar me institucionet e administratës publike.

GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP) GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)



Grupi Institucional i Punës (GIP) mbledh të paktën një herë në muaj dhe përbëhet nga drejtorive të ndryshme në strukturën e bashkisë dhe drejtohet nga pika e kontaktit të bashkisë. Anëtarët mbulojnë fushat e shërbimeve sociale, infrastrukturës, ujësjellës kanalizimeve, punësimit, shëndetësisë, arsimit, etj. Grupi Institucional i Punës përbëhet nga pesë vetë (tri gra) dhe takimet organizohen çdo tremujor. Në total, ky grup ka organizuar shtatë takime me 37 përfaqësues nga autoritetet vendore deri në janar 2020. Drejtuesit dhe përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme kanë pasur bashkëpunim shumë të mirë përsa i përket aktiviteteve të ndryshme të zhvilluara me sukses.

GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Grupi i Task Forcës së Bashkisë (TFB) përbëhet nga 2-3 pjesëmarrës të institucioneve vendore dhe 5-7 pjesëmarrës nga GVK dhe takimet organizohen çdo katër muaj. Në total, nga prilli 2018 deri në mars 2020 janë organizuar 11 takime me 37 përfaqësues të autoriteteve vendore dhe 78 anëtarë romë të GKV-së. Pjesa më e madhe e kërkesave të GKV-së është shqyrtuar dhe janë diskutuar zgjidhjet gjatë takimeve të TFB-së.

Dokumente Strategjike Vendore

Plani Vendor i Veprimit

Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019 -2022 është përgatitur me mbështetjen e programit ROMACTED. Ky plan është buxhetuar në një shumë totale prej 190,950,920 lekë. Ai është miratuar nga këshilli bashkiak i Elbasanit më 30 prill 2020.

Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financiar prej programit

- Projekti për "Përmirësimin dhe zgjerimin e angazhimeve, kapaciteteve, aftësive dhe njohurive të stafit të qendrës së komunitetit për ofrimin e një mësimdhënieje cilësore dhe efikase për fëmijët romë, rehabilitimin e urës që çon drejt qendrës komunitare" u financua nga skema e granteve të vogla e programit ROMACTED;
- Një tjetër projekt është paraqitur nga Bashkia Elbasan në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për rindërtimin e shtëpive në kuadrin e përshtatjes dhe përmirësimin e banesave ekzistuese.

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

- Lehtësimi i mbledhjes së të dhënave gjatë hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane me mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit të Elbasanit, Shërbimit Kombëtar të Punësimit të Elbasanit, Drejtorisë së Shëndetit publik, Zyrës së Gjendjes Civile të Elbasanit dhe Drejtorisë së Trajnimeve Profesionale;
- Rritja e sinergjisë dhe konsultimeve mes pakicave rome dhe egjiptiane dhe institucioneve vendore për Planin Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Zyrën e Arsimit nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, duke ofruar të dhëna dhe informacione për nxënësit romë dhe egjiptianë, akses në shkollat fillore me qëllim për të marrë informacione për numrin e largimeve nga shkolla, si dhe mbajtja e takimeve të shpeshta mes anëtarëve të GKV-së dhe prindërve për inkurajimin e fëmijëve për t'u kthyer në shkollë;
- Koordinim aktiv me përfaqësuesit vendorë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit për punësimin e tetë romëve dhe egjiptianëve; Drejtorja e Formimit Profesional në Elbasan, me regjistrimin në kurset profesionale të 25 të rinjve romë, si dhe Drejtorja e Shëndetit Publik, që organizoi aktivitete të përbashkëta me përfitim për pakicat rome dhe egjiptiane;
- Shkëmbimet e vazhdueshme të informacioneve dhe mbështetja e organizatave vendore rome të shoqërisë civile "Romano Sezi" dhe "Lëvizja Rinore Rome dhe Egjiptiane";
- Bashkëpunimi ROMACTED me Roma Education Fund (REF) në lidhje me shpërndarjen e informacioneve për mundësitë që ofron REF; pesë të rinj romë dhe egjiptianë përfituan në Elbasan nga këto mundësi arsimimi.

Kontaktet

Kryetari i Bashkisë: Z. Gledian LLATJA
Pika e Kontaktit e Bashkisë: Z. Shefki LIKA
Lehtësuesi ROMACTED: Z. Raxhi RAKIPI

